

10 masa të menjëhershme që Kosova duhet të ndërmarrë për të shënuar ditën ndërkombëtare të pyjeve!

Dita ndërkombëtare e pyjeve i gjen pyjet e Kosovës në një situatë shumë të rëndë. Në një anë, mungesa e koordinimit dhe prioritizimit institucional, e në anën tjetër niveli i zhvillimit ekonomik kanë bërë që gjendja e pyjeve të jetë larg të dëshiruarës. Megjithatë, Qeveria e Kosovës mund të bëjë shumë më tepër në prioritizimin dhe përmirësimin e gjendjes së pyjeve. Ja 10 masa të menjëhershme që Qeveria duhet t'i ndërmarrë për të shënuar denjësisht Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve:

1. Një strategji kombëtare e pyjeve dhe e kategorizimit të resurseve pyjore

Strategjia Kombëtare e Pyjeve 2010-2020 duhet të rishikohet menjëherë. Ka një mungesë totale të mekanizmave për vlerësim të politikave publike. Strategjia e Pyjeve 2010-2020 duhet rishikuar menjëherë në atë mënyrë që të evidentohen mangësitë dhe të hartohet një strategji e re me një qasje të re për pyjet: duke prioritetizuar ato!

2. Statistika të pyjeve

Data e fundit kur në ASK janë përditësuar të dhënat për mjedisin është fundi i vitit 2015. Ende nuk ka statistika reale se cila është gjendja e pyjeve, sa është niveli i depjllëzimit dhe cilat zona po zhveshen nga pyjet më shumë. Mungesa e statistikave të sektorit të cilat do të ndihmonin edhe në planifikim të politikave më të mira por edhe do ta rrisnin vetëdijen e publikut në lidhje me gjendjen e humbjes së pyjeve. Statistikat mbi pyjet duhet të publikohen në mënyrë të rregulltë, sistematike dhe të paraqiten në atë mënyrë që të jenë të kuptueshme për publikun e gjerë.

3. Koeficienti kombëtar i përdorimit të drurit

Kosova në legjislacionin e saj ende nuk e ka të definuar një koeficient kombëtar të përdorimit të drurit. Ky koeficient do të paraqiste në formë përqindje nivelin e përdorimit të detyrueshëm të secilit dru që prehet. Një Rregullore e veçantë do të specifikonte udhëzimet teknike se si kjo do të realizohej. Vendosja e një koeficienti të përdorimit të drurit dhe implementimi i tij do mundësonin përdorim të qëndrueshëm të pyjeve. Nëse shihet e nevojshme, duhet të ekzistojë një periudhë transitorë e vendosjes së obligimit e cila duhet të fillojë me një fushatë vetëdijësuese dhe me

lehtësimin e kontratave në mes të operatorëve të ndryshëm.

4. Transformim i mënyrës së ngrohjes

Një pjesë e konsiderueshme e sistemeve të ngrohjes së ekonomive familjare dhe industriale bazohen në djegie të drurit. Edhe pse druri përbën potencial për Kosovën në fushën e ngrohjes, mungesa e investimeve në efikasitet dhe energjisë dhe sistemet individuale të ngrohjes e bëjnë realizimin e ngrohjes shumë të kushtueshëm. Ka një mundësi të strukturave menaxhuese të atilla që do të ulnin kërkesën për dru për ngrohje dhe do të ofronin mundësi të zhvillimit të sistemeve të ngrohjes qendrore që do të optimizonin përdorimin e resurseve drurore.

5. Çertifikim i prerësve të drurit dhe vendosja e kufizimeve

Nevojitet një program kombëtar për licencimin e prerësve të drurit dhe vendosjen e kuotave për prerje të caktuara të drurit. Qeveria e Kosovës duhet të përpilojë një program të certifikimit dhe licencimit të prerësve të drurit dhe të përcaktojë kuota kufizuese për prerjen e pyjeve. Edhe përfituesit nga ekonomitë familjare duhen evidentuar dhe duhet ofruar asistencë që prerja e pyjeve t'i shërbejë rigjenerimit të tyre dhe jo zhvishjes dhe depyllëzimit.

6. Zero depyllëzim

Bazuar në gjendjen e tanishme të pyjeve, Kosova duhet të shpallë politikën “Zero Depyllëzim”! Kjo do të konsistonte në ndalimin e menjëhershëm dhe strikt të transformimit të zonave pyjore për destinime tjera, në ndalimin e prerjes së pandërprerë të pyjeve dhe të vendosjen kuota për komunitat që për një dru të prerë të mbjellin një numër të caktuar të drunjëve. Kjo politikë e re në të cilën sistemi i decentralizuar i qeverisjes në Kosovë do të merrte përgjegjësinë e tij, do ta mundësonte ruajtjen e zonave ekzistuese dhe zhvillimin e zonave të reja pyjore bashkë me mirëmbajtjen dhe rigjenerimin e vazhdueshëm të pyjeve në funksion të zhvillimit.

7. Promovimi, shitja dhe monitorimi i zbatimit të standardeve ISO 14001

Kosova, përkatësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes mekanizmave të kontrollit të cilësisë së produkteve duhet të promovojë shitjen dhe zbatimin e familjes së standardeve ISO 14001 mbi menaxhimin mjedisor. Ky standard ofron mjete praktike për kompanitë dhe organizatat e të gjitha llojeve që kërkojnë të menaxhojnë përgjegjësitë e tyre mjedisore. Ndër të tjera këto standard fokusohen në auditimet, komunikimet, etiketimi dhe analiza e ciklit jetësor etj. Kosova duhet ta promovojë aplikimin e këtij standardi dhe të ofrojë incentiva për bizneset dhe subjektet e tjera që pajisen dhe zbatojnë këtë standard.

8. Ndërlidhje të industrisë së drurit për menaxhim të qëndrueshëm

Qeveria dhe institucionet e tjera duhet të kenë në prioritet ndërlidhjen e masave si ndalimi i depyllëzimit dhe koeficientit kombëtar të përdorimit të drurit me industrinë. Industria përpunuese siguron efikasitet më të lartë të përdorimit që ruan resurset pyjore dhe mundëson zhvillim të

Ky propozim politikash është në kuadër të programit për Zhvillim të Qëndrueshëm, të financuar nga Rockefeller Brother Foundation (RBF). Propozimet e paraqitura këtu nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Rockefeller Brother Foundation.

qëndrueshëm të sektorit të pyjeve. Duke e rritur eficiencën e përdorimit të drurit dhe duke e promovuar përpunimin e tij mundësohet edhe përmbushje e standardeve evropiane për produkte vendore por edhe për mbrojtje dhe kultivim të qëndrueshëm të pyjeve.

9. Mbrojtje e biodiversitetit në pyje

Kosova duhet të ndërmarrë masa që do ta promovojnë zhvillimin e biodiversitetit dhe mbrojtjen e natyrës. Klima e Kosovës mundëson zhvillimin e llojeve të ndryshme të drunjëve të tilla që mund të kenë rol në zhvillimin ekonomik të vendit. Shumëllojshmëria e pemëve dhe shkurreve pyjore luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e burimeve ujore dhe kualitetit të tokës. Një plan kombëtar i shumëllojshmërisë së pyjeve është i domosdoshëm për të nxitur pyllëzimin me drunj të llojeve të ndryshme të përshtatshme për zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit.

10. Progame të edukimit dhe trajnimit

Kosova duhet të promovojë programe të edukimit mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve. Në kurrikulën shkollore duhet nxitur mbrojtja e pyjeve dhe rëndësia e tyre në zhvillimin ekonomik dhe kualitetin mjedisor. Kosova duhet të përgatisë kuadro të specializuar në fushat e mbrojtjes, shumimit dhe përpunimit të drunjëve. Vëmendje shumë më e madhe duhet dhënë për trajnimet për rojet e pyllit dhe duhen rishikuar kualifikimet dhe përgjegjësitë e tyre.